

Trajnimet për zhvillimin e kapaciteteve të të rinjve

Përgjatë dy javëve të para të dhjetorit u realizuan 6 trajnime për 30 studentë nga 3 qytete të vendit Tiranë, Korçë dhe Shkodër në kuadër të projektit **“Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë.”** që zbatohet nga SCiDEV së bashku me CCIS/QSKN dhe ESN mbështetur nga Agjencia kombëtare e Rinisë. Përmes këtyre trajnimeve studentët të cilët janë njëkohësisht edhe pjesëmarrës të debatit universitar u njohën më tepër me aktivizmin, rreth origjinës së tij, mënyrave si ai realizohet, cilat janë trendet e zhvillimit dhe fushat ku të rinjtë po shprehin vazhdimisht nismat e tyre.

Në mënyrë që trajnimet të ishin sa më të frytshme dhe ndërvepruese studentët u ndanë në 2 grupe që të kishin edhe më tepër hapësirë shprehjeje. Prof. Asoc. Dr. Nevila Xhindi fokusoi trajnimet e saj në Aktivizmin Publik dhe Politik duke bërë një historik të këtij të fundit dhe cilat janë arsytet që të rinjtë përqafojnë ose jo këtë lloj aktivizmi. Më tej ajo u fokusua në diskutimin me studentët se cilat janë fushat ku ata shohin primar aktivizmin dhe cilat mund të jenë disa ide të ndryshme nga ato që të rinjtë zakonisht ndërmarrin duke u dhënë këshilla të vlefshme se si ata të krijojnë ide inovatore dhe me shumë kreativitet dhe cilat janë elementët e domosdoshëm që mund ti bëjnë ato ide fituese.

Msc. Lutjona Lula në trajnimet e saj u fokusua në trajtimin e origjinës së aktivizmit në përgjithësi duke bërë një kronologji të trendeve të atëhershme dhe të sotme ku mbizotërues është aktivizmi digjital. Për këtë të fundit ajo trajtoi metodat digjitale dhe platformat që po përdoren nga të rinjtë sot duke dhënë shembuj se ku ato kanë qenë të sukseshme. Bazuar edhe në situatën e dy viteve të fundit pandemike duket të rinjtë i kanë përqaftuar këto lloj mënyrash për të bërë aktivizim dhe për këtë arsye edhe studentët u shfaqën tejet të motivuar të mësonin më tepër rreth tyre.

Trajnerja Orkidea Xhaferraj dhe trajneri Endrit Kuçi i fokusuan trajnimet e saj në përdorimin e inovacionit dhe krijimtarisë për aktivizim rinor me shembuj konkret nga RYCO dhe organizma të tjera si Këshilli i Europës.

Në përfundim të trajnimeve studentët u shprehën të kënaqur që ky program ka një përfshirje të gjerë dhe theksuan që kanë nisur që me gurpet e tyre të krijojnë pak nga pak idetë mbi të cilat do të krijojnë nismat e tyre. Këto trajnime shoqëruar me manualin e përgatitjes së nismave ju vijnë atyre në ndihmë për ta patur sa më të lehtë hapin e parë drejt formësimit të aktivizmit që ata do të kryejnë dhe financohen më tej.

Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështet nga:

Trajnime

AGJENDA

[Dhjetor 2021]

Data& Ora	Tema e Trajnimit	Trajnere
04/12/2021 <i>14:00-17:00</i>	Aktivizimi publik dhe politik Mënyrat si të rinjtë nisin aktivizimin e tyre	Prof.Asoc.Dr Nevila Xhindi CCIS
Data 05/12/2021 <i>14:00-17:00</i>	Mjetet digjitale të aktivizimit të të rinjve Si ka nisur aktivizmi digjital dhe cilat janë trendet	Lutjona Lula ESN
06/12/2021 <i>14:00-17:00</i>	Inovacioni dhe krijimtaria Shembuj nga RYCO dhe COE	Orkidea Xhaferraj dhe Endri Kuçi SCiDEV

Projekti "Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë" mbështet nga:

(Trajnime)



AGJENDA

[Dhjetor 2021]

Data& Ora	Tema e Trajnimit	Trajnere
11/12/2021 <i>14:00-17:00</i>	Aktivizimi publik dhe politik Mënyrat si të rinjtë nisin aktivizimin e tyre	Prof.Asoc.Dr Nevila Xhindi CCIS
12/12/2021 <i>14:00-17:00</i>	Mjetet digjitale të aktivizimit të të rinjve Si ka nisur aktivizmi digjital dhe cilat janë trendet	Lutjona Lula ESN
13/12/2021 <i>14:00-17:00</i>	Inovacioni dhe krijimtaria Shembuj nga RYCO dhe COE	Orkidea Xhaferraj dhe Endri Kuçi SCiDEV

Projekti "Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë" mbështet nga:


Foto nga trajnimet



Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështet nga:


Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i të rinjve: Studimet dhe realiteti

- Realiteti dhe studimet tregojnë një pamje jo shumë entuziaste të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit rinor në të gjitha nivelet kudo në Botë.
- Literatura bashkëkohore që studion pjesëmarrjen rinore në nivele të ndryshme të vendimmarrjes sugjeron se angazhimi politik është i lidhur me shkallën e zhvillimit dhe cilësinë e demokracisë, me besimin që qytetarët krijojnë me demokracinë funksionale të një vendi.
- Për shoqëritë në tranzicion standardi më i ulët i jetesës, ecejakja e vlerave dhe anti-vlerave si dhe mungesa e një kulture politike të trashëguar shtojnë dozën e problematikave me të cilat përballlet vendi.
- Gjithkush i mbërthyer mes të djeshmes dhe të sotmes, të moralshmes dhe të pamoralshmes, mes përhumbjes dhe pushtetit voton për atë më praktikën që i siguron mbijetesën apo fuqizimin.



Diskutojme...

Pengesat e perceptuara të të rinjve për t'u përfshirë në procese/struktura vendim-marrëse e politikëbërëse



Projekti "Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë" mbështet nga: